

Prof. Dr. Edi SHUKRIU

DEA DARDANICAE - IKONOGRAFIA, SIMBOLET DHE FUNKSIONET

Perëndesha Dardane, e paraqitur si Dea Dardanicae në tri monumente të periudhës romake, është një hyjneshë që del me funksione të llojshme dhe ofron mundësi për përcjelljen e zhvillimit të kulteve dhe të besimit dardan në faza të ndryshme kohore. Monumentet e përkushtuara Perëndeshës Dardane duken me një ikonografi të pasur dhe shumësi të simboleve, për ta arritur kulmin me trajtim të labirintit, si shprehje teogjenike, kozmologjike dhe filozofike. Kështu, monumentet dëshmojnë rëndësinë e Perëndeshës dhe, njëkohësisht, shtrojnë nevojën për një studim më të hollësishëm të monumenteve të cilat i janë përkushtuar asaj. Po ashtu, përmes studimit të tyre ofrohet mundësia për një rinjohje më të përafërt, ndonëse jo të plotë në këtë fazë të hulumtimeve, të zhvillimit të kulteve dhe të besimit dardan dhe nivelit të krijuar të një sistemi religjioz dardan, gjë që mëtohet të fillohet me këtë punim.

Që në fillim duhet thënë se studimi i këtij lloji ndeshet me disa sfida të caktuara, siç janë: (1) pamjaftueshmëria e të dhënave të autorëve antikë, (2) mungesa e objekteve relevante të periudhës pararomake dhe (3) numri i vogël i monumenteve epigrafike të periudhës romake me përkushtim perëndive autoktone. Autorët antikë nuk trajtojnë fare çështjet e besimit tek dardanët, ndërsa, në anën tjetër, ka fare pak materiale arkeologjike të periudhës pararomake, të cilat do të mundësonin krijimin e një pasqyre më reale të zhvillimit të besimit dardan pararomak. Mungesa e monumenteve të periudhës pararomake lidhet me mosgjetjen e materialeve arkeologjike të shek. IV-I dhe me traditën e drugëdhendjes, e cila u përcoll në gur/mermer pas pushtimeve romake. Si pasojë, emrat e perëndive vendëse u njohën vetëm nga monumentet gurore të periudhës romake të fillimit të shek. III, dukuri kjo që lidhet me kthimin e traditave vendëse. Në dy shekujt e parë të sundimit romak perënditë vendëse janë të pranishme me emra të perëndive

të huaja - *interpretatio romana*, andaj edhe identifikimi i tyre bëhet më i vështirë.

Perënditë e respektuara në Dardani janë të shumta, por me prejardhje dardane janë dëshmuar deri më sot vetëm emrat e dy prej tyre: (1) Perëndesha Dardane (Dea Dardanica) dhe (2) hyji Andin (Andinus). Përderisa Perëndesha Dardane është dëshmuar në disa monumente votive, hyji Andin është dëshmuar deri më sot vetëm në monumentin e Kaçanikut dhe në atë të Vushtrisë.¹

I. Monumentet votive përkushtuar Perëndeshës Dardane

Në mesin e tri monumenteve votive me përkushtim të sigurt Perëndeshës Dardane (Deae Dardanicae), dy sosh janë gjetur në Romula-Malva të Rumanisë, pranë Alba Julia, në veri të Transilvanisë (monumenti 1, 2)² dhe një në Smirë të Vitisë (monumenti 3).³

Duket se kësaj hyjneshe i janë përkushtuar edhe monumenti votiv nga Baja e Kurshumlisë (monumenti 4)⁴ dhe shtatorja e zbuluar në Medianë të Nishit (monumenti 5).⁵ Këtij numri duhet shtuar edhe monumentin në kishën paleokristiane në Lypjan, monedhën me figurë hyjneshe dhe mbishkrimin DARDANICI (monumenti 6)⁶, si dhe Bustin e Perëndeshës, të njohur si Busti i Gruas nga Klllokoti (monumenti 7).

¹ J.A. Evans, *Antiquarian researches in Illyricum*, Part III-IV, Westminster, 1885, 74, f.n. a; Th. Mommsen, *CIL III*, 8184; F. Papazoglu, *Srednjbalkanska plemena u predrimsko doba*, Akademija Nauka i Umetnosti Bosnje i Hercegovine, Sarajevo, 1969, 173; Z. Mirdita, *Antroponomia e Dardanisë në kohën romake*, Rilindja, Prishtinë, 1981, 246, nr. 205.

² D. Tudor - C. Vladescu, *Dardanii la Romula-Malva*, *Apulum X*, Alba Julia, 1972, 183-190. Mungon ana e djathtë e monumentit.

³ E. Shukriu, *Dea e Dardanisë dhe mozaiku i Orfeut*, *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, XIV/1989, Fakulteti Filologjik, Prishtinë, 1989.

⁴ Z. Mirdita, v.c., 247, nr.208; N.Vulić, *Spomenik 71 (SKA)*, Beograd, 1931, 98.

⁵ N. Vulić, *Antički spomenici naše zemlje*, *Spomenik 98, SANU*, Beograd, 1948, nr.237; A. Nenadović, *Raniji rimski nalasci u Nišu i njegovoj blizoj okolini*, *Limes u Jugoslaviji I*, Beograd, 1961, 169; Ch. Picard, *Observation archelologique en Yougoslavie*, 1953, *comptes rendu de l'Academie des Inscriptions*, 1953; P. Petrović, *Niš u antičko doba*, Niš, 1976, 148; A. Jovanović, *Neki aspekti problema skupnog nalaza skulptura sa Medijane kod Niša*, *Starinar XXIV-XXV*, Beograd, 1976; I njëjti, *Prilog proučavanju skulptura sa Medijane*, *Niški Zbornik*, Niš, 1980, 53-59.

⁶ *L'Annee Epigraphique 1952*, 61, nr.192; N. Vulić, *Spomenik 98, SAN*, Beograd, 1948, 221; Z. Mirdita, v.c., 252, nr. 239.

1. Perëndesha Dardane me edh nga Romula-Malva

Në Romula-Malva të Rumanisë është zbuluar monumenti votiv përkushtuar Perëndeshës Dardane në vitin 1969 dhe ai ka një trajtësim figurativ të Perëndeshës në relief. Monumenti u ngrit në gjysmën e parë të shekullit III,⁷ nga dy dekurionë të kolonisë, që të dy me prejardhje nga Dardania. Monumenti është punuar në mermer, në relief të thellë, me elemente të theksuara dhe me trajtim paksa të vrazhdët, karakteristikë kjo e kulturës provinciale romake. Dimensionet janë 44 x 27 x 4 cm. Kornizat janë të theksuara me pjesë të epërme gjysmëharkore, ku është shënuar formula e përkushtimit (*RDANIC E*), ndërsa në pjesën e poshtme janë shënuar dedikantët. Emri i dedikantëve nuk është ruajtur, pos prapashtesës *us* të emrit të parë dhe shkronjave *el* të emrit të dytë, që mundëson leximin e emrit të dytë si Aurelius.⁸ Në kornizën e epërme, mbi kokë të hyjneshës, është paraqitur një element konik në trajtë gjysmëhëne (semilunare).

Figura e hyjneshës zë gjithë sipërfaqen e monumentit. Ajo mban në dorën e majtë, tek gjoksi, edhin, ndërsa në dorën e djathtë duket se mban një gese.⁹ Në anën e majtë të saj qëndron kënduesi, i vendosur mbi altar. Hyjnesha ka të veshur një tunikë të gjatë dhe dy tunika të shkurtëra, me palë të pasura. Mbi kokë ka shaminë, e cila i bie shlrshëm mbi supë, element ky mjaft i rëndësishëm etnografik që lidhet me traditën dardane/ilire. Sipas studiuesve D. Tudor dhe C. Vladescu hyjnesha, si *interpretatio romana*, prezanton një hyj sinkretik që personifikon Dardaninë, me elemente të gërshetuara të natyrës, plleshmërisë dhe ato htonike.¹⁰

2. Perëndesha Dardane me enë të bollëkut nga Romula-Malva

Monumenti i dytë përkushtuar Perëndeshës Dardane në Romula-Malva të Rumanisë u zbulua në vitin 1969. I ngjashëm me të parin është monument reliefor i punuar në mermer. Mungon pjesa e epërme dhe e djathtë e tij.

⁷ D. Tudor - C. Vladescu, v.c., 183-190; D. Tudor, *Oltenia romana*, Bukarest, 1978, 369, fot. 102; J. Gage, M. Leglay, H. Pflaum, P. Wuilleumier, *L'annee epigraphique*, Presses Universitaires de France, Paris 1972, 138-139. Mungon pjesa e djathtë e monumentit.

⁸ D. Tudor - C. Vladescu, v.c., Fig. 1. Lartësia e shkronjave 0,8-1,5 cm. Formula e përkushtimit është vendosur në pjesën e epërme të monumentit: ...RDANIC E, ndërsa teksti i mbishkrimit në pjesën e poshtme të monumentit: ...US DEC COL ET EL / ...L EX VOTO POSUERUNT. Leximi i tekstit: [Deae Da]rdanic[a]e / [...]us dec(urio) col(oniae) et [A]el(ius) / [...] dec co]l(oniae) ex voto posuerunt.

⁹ D. Tudor dhe C. Vladescu supozojnë se hyjnesha mban skeptrin.

¹⁰ Të njëjtët, 188.

Dimensionet e ruajtura janë 19 x 15 x 3 cm.¹¹ Monumenti ka korniza të theksuara dhe teksti i mbishkrimit gjendet në pjesën e poshtme të kornizës. Gjithë sipërfaqen brenda kornizave e zë figura e hyjneshës, nga e cila është ruajtur vetëm një pjesë e veshjes me shumë palë dhe një krater i mbushur me fruta, që gjendet pranë këmbës së saj të majtë. Ngjashëm me relievin e parë hyjnesha ka të veshur fustan të gjatë me dy tunika të shkurtëra mbi të.

Kognomen Dardanus që mban dedikanti, si dhe krahasimi me monumentin e parë, sjellin në përfundim, siç konkluduan edhe studiuesit e këtij monumenti, se monumenti i është përkushtuar një hyjneshe të fertilitetit dhe të vejetacionit.¹²

3. Perëndesha Dardane dhe dy labirintet nga Smira

Monumenti i tretë përkushtuar Perëndeshës Dardane u zbulua në Smirë të Vitisë më 1988.¹³ Ky është monumenti më i vlefshëm epigrafik i gjetur deri më sot në Kosovë, jo vetëm për nga teonomia, por edhe për shkak të paraqitjes simbolike unike të labirintit rrethor dhe të arkitekturës katërfaqësore të saj. Monumenti është punuar në mermër të bardhë, të përshkuar me ngjyrë të përhimtë dhe është skalitur në katër faqe, me dy fusha të mbishkrimit dhe dy fusha simbolike-ornamentale. Ka dimensione 78 x 36 x 37 cm. Fushat e simboleve dhe të mbishkrimeve kanë korniza të theksuara me dimensione 34,5 x 22,5 cm. Kapiteli dhe bazamenti i monumentit janë dëmtuar gati tërësisht. Në pjesën e poshtme të kapitelit duken gjurmët e gjetheve të lërthit, ndërsa nën to është një brez me vija relievo. Në pjesën e epërme kapiteli ka edhe elemente të tjera, të cilat nuk mund të definohen për shkak të dëmtimeve. Monumenti i punuar me mjeshtri është ngritur në vitin 211.¹⁴ Në dy faqet anësore të tij janë bërë në relief dy paraqitje të ndryshme, në njërin është labirinti rrethor dhe në tjetrën labirinti katërkëndësh. Me këtë rast do t'i kushtohet vëmendje simbolit të parë, si simbol autokton dhe në funksion të shpjegimit të

¹¹ Të njëjtët, 188; J. Gage..., v.c., 139. Lartësia e shkronjave 1,3 cm. Në pjesën e poshtme është ruajtur teksti: ...VRDARDAN / ...MPOSVI. Leximi i tekstit: [...A]ur (elius) Dardan / [us votu]m posui (Aurelius Dardanus votum posui).

¹² Të njëjtët, 186-187.

¹³ E. Shukriu, v.c. Teksti i mbishkrimit: Deae / Dard(anicae) / Artorius / Heracli / tus spec(ulator) / leg(ionis) IIII Fl(aviae) / v(otum) s(olvit) l(ibens) m(erito) / Gentiano et Basso.

¹⁴ E njëjta, Dea Dardane dhe monumentet e tjera nga Smira, Buletini i Fakultetit Filozofik, Prishtinë, 2000.

funksioneve të Perëndeshës, ndërsa të dytin duhet parë si përforsim të domethënies së të parit.

Labirinti rrethor përbën një kompozicion ndërlidhës midis paraqitjes së labirintit rrethor, hardhisë së rrushit, lerthit dhe nyjës profilaktike. Labirinti është paraqitur në pjesën qendrore të faqes dhe përbëhet nga një rreth i plotë dhe pesë rrathë të brendshëm. Rrathët, duke u ndërlidhur, formojnë gjashtë kryçe të thyera (svastika: rrethet 2-4-6 dhe 3-5), dhe e ndajnë këtë pjesë të kompozicionit në tri hapësira të mëdha. Në qendër gjendet gjysmësfera e theksuar, po ashtu e ndarë me gjysmëharqe në tri pjesë. Secili cep nga të tri harqet e sferës është vendosur në drejtim të hyrjes në nën-kompozicionet që i formojnë svastikat. Mbi labirint gjendet kalaveshi i rrushit, në anën e djathtë, dhe gjethi i hardhisë, në anën e majtë. Hardhia ndërlidhet me një rrip gjysmëharkor me gjethet e lerthit që gjenden në fund të fushës kompozicionale. Degët e lerthit kanë një nyjë të theksuar midis tyre, njënyjë profilaktike. Pa dyshim, paraqitja e këtij labirinti të një rënëdësie të veçantë është shprehje e një kompleksiteti teogonik, kozmogonik dhe filozofik të kohës.

4. Perëndesha Dardane nga Mediana

Në qytetin antik Mediana afër Nishit është zbuluar në vitin 1933 shtatorja e një hyjneshe, të cilës i mungon koka. Shtatorja është punuar në mermer të bardhë dhe ka lartësi të ruajtur prej 1,34 m. Hyjnesha ka të veshur një tunikë të gjatë (hiton) dhe një tunikë të shkurtër mbi të (himation). Kokën e kishte të mbuluar me shami, siç duket nga gjurmët e ruajtura tek shpatullat dhe shpina. Figura duket në lëvizje, me peshë të trupit mbi këmbën e majtë dhe me këmbë të djathtë paksa të lakuar. Në dorën e djathtë, tek gjoksi, mban një viç, ndërsa në dorën e majtë, të lëshuar poshtë, qesen (marsupium). Pranë këmbës së majtë gjendet koka e derrit faran (derr për damaz), ndërsa mbi të gjendet sëpata dytehëshe (labrys).

Atributet e ndryshme që paraqiten në shtatoren e Medianës e bënë të vështirë përcaktimin e emrit të hyjneshës së paraqitur, mu pse veç e veç duken tek hyjnitë e caktuara, por asnjëherë si në rastin që trajtohet. Kështu, viçi, simbol i plleshmërisë e mirëqenies, është atribut qendror i taurobolisë në kultin e Kibelës, Mitrës dhe të Jupiter Dolihenit. Viçi konsiderohet si nismëtar i kosmogonisë, sepse nga gjaku i tij nis jeta e re. Labrysi po ashtu paraqitet në kultin e Kibelës, si edhe viçi, por Kibela gjithëherë paraqitet e ulur, kryesisht midis dy luanëve, me instrumentet e kultit të saj timpanën e paterën, të cilat mungojnë në shtatoren e Medianës. Viçi dhe labrysi janë të pranishëm edhe në kultin e Jupiter Dolihenit, por gjithëherë në një paraqitje

tjetërfare ikonografike. Derri faran është simbol përcjellës i Dianës, por asnjëherë së bashku me labrisin e viçin. Qesja (marsupium), si simbol i mirëqenies dhe si materializim i pronës së njeriut, është atribut përcjellës i Merkurit dhe gjysmëhyjti Ubiritasit, por as këta nuk i kanë atributet e tjera që i ka shtatorja e Medianës. Andaj, përderisa N. Vuliq e përshkruan këtë monument si një shtatore femre, pa përcaktim kronologjik dhe attribute religjioze,¹⁵ Ch. Picard, duke e parë si hyj sinkretik, e sheh si një interpretim autokton të Kibelës, hyjti suprem të Azisë së Vogël,¹⁶ A. Nenadović si Dianë, hyjneshë të gjuetisë,¹⁷ ndërsa P. Petroviq si personifikim i një hyji autokton të tokës dhe gjuetisë, me funksione të Kibelës e Dianës.¹⁸

A. Jovanović, në një studim më të gjatë, duke i parë atributet si shenja me kuptim të caktuar dhe jo si simbole universale, shtatoren nga Mediana e sheh si personifikim të Dardanisë.¹⁹ Në esencë, interpretimet e ndryshme të shtatores nga Mediana e pranojnë interpretimin autokton, si dhe funksionet e shumta të hyjneshës së prezantuar. Gjithnjë duke mbajtur parasysh se territori ku është zbuluar shtatorja i përkiste Dardanisë dhe pas analizës së monumenteve të tjera, mund të përfundohet se shtatorja nga Mediana prezanton Perëndeshën Dardane dhe me të edhe vetë Dardaninë. Fakti se ikonografia e shtatores nga Mediana përputhet me atë nga Romula-Malva dhe se në këtë të dytën qëndron përkushtimi Deas Dardane, dhe jo Deas së Dardanisë, e përforcon këtë qëndrim.

5. Dardanae sacrum nga Baja e Kurshumlisë

Në Bajë të Kurshumlisë është zbuluar një monument përkushtimor me emër të shkurtuar hyji: *Dar sacrum*. Monumenti është ngritur në vitin 206, gjatë shërbimit konsullar të G. Senecionit dhe Aemilianos.²⁰ N. Vuliq dhe Z. Mirdita, duke e interpretuar formulën përkushtimore të dhënë si shkurtesë, e shohin atë si përkushtim hyjnisë së Dardanisë: *Dar(daniae) sacrum*.

¹⁵ N. Vulić, v.c., nr.237.

¹⁶ Ch. Picard, v.c.

¹⁷ A. Nenadović v.c., 169.

¹⁸ P. Petrović, v.c., 148.

¹⁹ A. Jovanović, v.c., 54-55.

²⁰ Dar sac / Philoxenus Aug / n ser vilic / stat Aquar Bassianae / templum ex voto / a solo restituit / v ls / ...G. Senec et Aemiliano cos. N.Vulić, v.c., nr.221, dhe Z. Mirdita, v.c., 252, nr.239, duke e parë monumentin si përkushtim Deas së Dardanisë, e lexojnë siç vijon: Dar(daniae) sac(rum) / Philoxenus Aug(ustorum) / n(ostrorum) ser(vus) vilic(us) / stat(ionis) Aquar(um) Bassianae? / templum ex voto / a solo restituit / v(otum) l(ibens) s(olvit) / ...G. Senec(ione) et Aemiliano co(n)s(ulibus). Siç duket nga teksti në Bajë të Kurshumlisë ekzistonte edhe tempulli i hyjit.

Ndonëse nuk përjashtohet kjo mundësi, mendoj se përkushtimi i është bërë më parë Perëndeshës Dardane (Deae Dardanicae), kur kihet parasysh monumenti nga Rumania, ku një përkushtim i tillë është më se i sigurt: (*Da*)rdanica(e). Fakti se i është dhënë një tempulli të bajës termale provon lidhmërinë e Perëndeshës edhe me funksionet e hyjit të burimeve.

6. Monumenti i Perëndeshës në kishën e Shën Florit në Lypjan

Në kishën paleokristiane në Lypjan është zbuluar një fragment monumenti votiv, i cili, po ashtu, duket t'i jetë përkushtuar Perëndeshës Dardane. Monumenti gjendet në kishë në përdorimin e tij sekundar dhe me gjasë është sjellë nga Ulpiana apo ndonjë lokalitet tjetër antik në afërsi. Nga teksti i dëmtuar ka mbetur vetëm formula e përkushtimit: *Deae*, pa emër të hyjneshës, dhe emri i dedikantit, *Caius Oppius*.²¹ Mungesa e emrit të hyjneshës solli tek supozimet se monumenti i është përkushtuar Junonës ose Dianës.²² Analiza e monumenteve të tjera shpie në përfundim se edhe ky i është përkushtuar vetë Perëndeshës Dardane, të njohur dhe që del me emrin latinisht *Dea* (Perëndeshës), gjithnjë duke mbajtur parasysh edhe dukurinë e paraqitjes së hyjnive vendëse nga shek. III me emrat e tyre dhe jo më me interpretim romak, nga fakti se monumenti është ngritur në shek. III dhe nga paraqitja e shpeshtuar e monumenteve përkushtuar Perëndeshës Dardane në këtë kohë.

7. Monedha me figurë të hyjneshës dhe mbishkrimin DARDANICI

Dy monedha me mbishkrim *DARDANICI* të kohës së sundimit të Trajanit (shek. II) janë po aq me interes për shqyrtimin e pamjes së Deas Dardane në monumente të ndryshme, aq më tepër që që të dyja kanë në revers figurën e një hyjneshe.

Monedha I:

avers: IMP. CAES. NERVA TRAIAN. AVG. GERM. Busti me kurorë i kthyer në të djathtë.

²¹ Z. Mirdita, v.c., 254, nr.250: DEAE I.....I / C(aius) Oppius / C(ai) filius v(ivo) p(osuit)/.

²² I njëjti, v.c., 254.

revers: DARDANICI. Figurë femre që mban kallirin e grurit me njëren dorë dhe cepin e hitonit me tjetrën.²³

Monedha 2:

avers: IMP. CAES. NERVA TRAIAN. AVG.

revers: DARDANICI. Figurë femre e kthyer në të djathtë, në njëren dorë mban kallirin e grurit dhe në tjetrën cepin e tunikës së gjatë (hitonin).²⁴

Figura u lidh me hyjnesha prejardhjesh të ndryshme, si Rah, Annona, Abundantia apo Cera. H.Cohen që i vetmi që e konsideroi si personifikim të Dardanisë, rrjedhimisht Dea të Dardanisë, ndërsa A. Jovanović, duke dhënë argumentimin se në monedhat e minierave nuk janë gjetur dëshmi me aluzione gjeografike, e hedh poshtë këtë mundësi.²⁵ Fakti se Perëndesha Dardane nuk duket vetëm si hyj i Dardanisë, pra i një territori të caktuar, e zbeh argumentin se është fjala për një aludim gjeografik në rastin e reverseve të monedhave të minierave me mbishkrimin *DARDANICI*. Kështu, mendimi i H.Cohen del më afër sëtë vërtetës, por jo më si Perëndeshë e Dardanisë, përkatësisht personifikim i territorit të Dardanisë, por si Perëndeshë Dardane, hyj me funksione të sublimuara.

8. Busti i Perëndeshës Dardane nga Kllokoti

Në Vërban të Vitisë është gjetur busti i një gruaje, i skalitur në mermer, që u bë i njohur në opinion me emrin *Busti i Gruas nga Kllokoti*. Busti u takon shek. II-III dhe në të është paraqitur një grua me veshje autoktone. Monumenti nuk përmban asnjë mbishkrim, gjë që është e pazakontë. Sikur në të të ishte paraqitur një pjesëtare e aristokracisë vendëse e periudhës romake, siç supozohet, në të do të ishte skalitur edhe emri i saj, aq më parë kur dihet se monumentet ngriten për ta përjetësuar figurën e prezantuar dhe se monumentet e tilla prej mermeri janë të kushtueshme në çdo kohë. Pse atëherë në monument nuk është skalitur edhe emri i gruas së prezantuar? Përgjigjja në këtë rast duket shumë e qartë: busti paraqet Perëndeshën

²³ H. Cohen, *Description Historique des Monnaies Frapees sous l'Empire Romain II 2*, Rollin & Feuarent, Paris, 1882, 32, nr. 138.

²⁴ I njëjti, v.c., 32-33, nr. 138, 139; H. Mattingly, *British Museum Catalogue, Coins of the Roman Empire III*, London, 1936, nr. 234; A. Jovanović, v.c., 57; V. Simić - M. Vasić, *La monnaie des mines romaines de l'Illyrie*, *Revue numismatique* XIX, 1977, 56-57; B. Zmajić, *Rudnički novci rimskog carstva*, *Numizmatičke Vijesti* 21, Zagreb, 1964, 1-9.

²⁵ A. Jovanović, v.c., 57.

Dardane, të cilën e njihnin të gjithë. Këtë mendim e mbështet edhe paraqitja e ngjashme figurative e Perëndeshës Dardane në monumentin e Rumanisë.

II. Simbolet e Perëndeshës Dardane

Në monumentet votive përkushtuar Perëndeshës Dardane paraqiten simbole të ndryshme të kultit, shumësia e të cilave tregon fazat e zhvillimit të kultit të Deas dhe, më pas, sublimin e funksioneve të llojllojshme në këtë hyjneshe. Simbolet që paraqiten në monumentet përkushtuar Perëndeshës Dardane janë: edhi, gjeli, diadema në trajtë gjysmëhëne dhe qesja (monumenti i dekurionëve dardanë në koloninë Romula-Malva), shporta e bollëkut (monumenti i Aurelius Dardanus nga Romula-Malva), labirinti rrethor me svastika, labirinti katërkëndësh, hardhia e rrushit, gjethet e urthit dhe nyja profilaktike (monumenti i Smirës) dhe derri faran, sëpata dytehtëshe (labrysi) dhe qesja (shtatorja në Mediana).

Pasi që simbolet e sipërpërmendura shprehin edhe funksionet e caktuara, zbërthimi i tyre ofron mundësi për njohjen e funksioneve të nduarduarshme të Deas në kohë të ndryshme dhe përcaktimin e rolit të saj në shoqërinë dardane, si dhe për zhvillimin e religjionit dardan në përgjithësi. Në vijim do të zberthehet domethënia e simboleve sipas hershmërisë së paraqitjeve të tyre dhe analogjitë me hapësirat e ndryshme.

Edhi.- Perëndesha Dardane mban edhin në kraharor në monumentin nga Romula-Malva (monumenti 1). Paraqitjet e edhit/dhisë janë shumë të hershme dhe të shpeshta tek popujt e parahistorisë së hershme. Edhi dhe dhia ishin një prej burimeve të para të ekzistencës së njeriut (para prodhimeve bujqësore) dhe dukja e tyre shpreh aspektin utilitar të kulteve të hershme. Dhia, si simbol i të gjitha forcave që ndihmojnë regjenerimin biologjik të natyrës, lidhet me kultin e pleshmërisë, fillimisht me atë të shtazëve, duke qëndruar në lidhmëri të ngushtë me kultin e Nënës së Madhe (Magna Mater). Për këtë popujt e lashtë të Lindjes Nënën e Madhe e quajtën edhe *lozë e dhisë*.²⁶

Edhi/dhia/cjapi flijoheshin në fillim për demonët dhe më pas për hyjnitë, që duhej të mëshiroheshin që natyra të jepte fruta të nevojshme për jetë. Sipas besimit parahistorik, shtazët e flijuara, përkatësisht derdhja e gjakut të tyre në dhe, si dhe shpërndarja e trupit të copëtuar nëpër fusha, posaçërisht të organeve regjeneruese, siguronin pleshmërinë e dëshiruar dhe të nevojshme

²⁶ Dhia ishte shenjë sumeriane e jetës: J. Chevalier - A. Gheerbrant, Rječnik simbola, Nakladni Zavod, Zagreb, 1983, 360.

të natyrës. Kështu, në Iranin e hershëm hyjnesha e plleshmërisë paraqitet me brirë mbi kokë, ndërsa më vonë, duke dalë në trajtë cjapi, vihet në lidhje me kultin e diellit, respektivisht me hyjin qiellor – Diellin. Në këtë mënyrë bëhej lidhja e totemit me kultin e diellit. Kjo lidhmëri ndeshet edhe në mitologjinë pellazgo-helene, ku nimfa Amaltea, e cila paraqitet në fillim vetë dhi, del si bijë e Heliosit (Diellit), përkatësisht si personifikim antropomorf i dhisë.²⁷ Lidhmëritë e dhisë me kultin e Demetrës janë po aq të hershme. Mbi hershmërinë e pranisë dhe rolit të dhisë si hyj femëror flet edhe vendosja e birit dhe dhisë në radhën e yjeve nga ana e Zeusit, në shenjë mirënjohjeje që e kishte ushqyer si foshnjë (Ylli Dhia me tre kecat e saj).²⁸

Më vonë dhinë e zëvendësoi cjapi, i cili u flijua për Zeusin dhe Hermesin, por ky mbeti në lidhje të ngushtë me kultin e Demetrës dhe të Dionisit, për t'u bërë në antikë atribut i Dionisit dhe Afërditës, si simbol i epshtit dhe plleshmërisë.²⁹ Për këtë lidhmëri flet fakti se në Lesbos, nga shek. VIII p.e.r., Dionisi u quajt edhe - *kamelios*, ndërsa pjesëmarrësit kryesorë të ritualeve të kultit maskoheshin si cjepë. Religjioni i hershëm romak po ashtu njih paraqitjet e cjapit, respektivisht të cjapit të shenjtë (*sacer hircus*), i cili mbarësonte gratë me urdhrin e Junonës.³⁰

Për rolin e hershëm dhe të rëndësishëm të dhisë/cjapit tek popujt e Ballkanit flasin paraqitjet e tyre në kulturën neolitike të Vinçës, që duken në trajtë terrakotash apo si aplikacione enësh.³¹ Si simbol kulti autokton cjapi është mjaft i pranishëm në besimin ilir, deri më tash i dëshmuar kryesisht në lidhmëri me hyjt Bind dhe Vidas. Kështu, ai del si simbol i hyjit Bind, respektivisht është një shtazë e hershme kulti që i flijoheshin këtij hyji të burimeve dhe ujërave. Ndonëse Bindi shpesh është identifikuar me Neptunin romak, hyji ilir kishte funksion edhe plleshmërinë, për ç'gjë flet flijimi i cjapit dhe i gjedheve. Cjapi është dëshmuar arkeologjikisht, pos tjerash, në tempullin e hyjit ilir Bindit në Privilice afër Bihaqit.³² Cjapi i është flijuar edhe hyjit ilir Vidas, hyj i pyjeve dhe i kullosave. Përderisa në kuptimin ikonografik ky hyj ilir nuk është dalluar nga Pani helen apo

²⁷ T. Dhama, v.c., 29, 56.

²⁸ I njëjti, v.c., 29, 56.

²⁹ Preller-Robert, *Griechische Mythologie*, Aufl. IV 1894, 380. Satiri/pani, përcjellës në kultin e Dionisit, tek helenët quhej *he tragoi*: cjav.

³⁰ A. Stipčević, v.c., 108, f.n.172.

³¹ M. Vasić, *Preistorijska Vinča III*, Beograd, 1936, T.CXXX, fig. 604 b.

³² Tre cjepë janë gdhendur edhe në monumentin votiv të tempullit të Privilices, dy në pozitë heraldike para altarit, në pjesën e epërme të monumentit, dhe një nën fushën mbishkrimore. Është fjala për një traditë ilire parahistorike, të pranishme para pushtimeve romake. Kjo dëshmohet nga emri ilir i hyjit, emri i dedikantit dhe emri i japodëve, si fis të cilit dedikanti i përkiste: A. Stipčević, v.c., 109, 171-172.

Fauni/Silvani romak, në aspektin e funksioneve ky ka luajtur rol më të rëndësishëm në besimin ilir,³³ siç është rasti edhe me Bindin në krahasim me hyjtë e përmendur Helenë e romakë. Figura e cjapit, e vendosur pranë Silvanit, u gjet e gdhendur në një shkëmb pranë Duvansko Poles, territor po ashtu ilir.³⁴ Figurat e cjepëve prej bronzi duken shpesh në shek. VI p.e.r., siç janë gjetjet në varret në Trebenishtë (si dhurata htonike) e në Gjevgjeli,³⁵ cjapi i Prizrenit,³⁶ si dhe ato të zbuluara në Sirmium (Mitrovicë e Sremit, shek. I-II)³⁷ dhe Ohër (shek. II-III).³⁸

Pa dyshim, paraqitja e edhit në kraharor të Perëndeshës Dardane shpreh lidhmërinë e ngushtë me traditën e hershme parahistorike të kultit të dhisë, të plleshmërisë dhe të regjenerimit të natyrës. Në kuptimin më të gjerë është një relik i kultit të Nënës së Madhe, që shumë kohë më parë lindi si produkt i shoqërisë sedentare apo të mbase një shoqërie matrilineare, ashtu siç duket të ketë ngjarë me Nënë Hyjneshë kelte.³⁹ Edhi ishte shtazë flijimi në kultin e Perëndeshës Dardane, siç ishte cjapi në kultin e mëvonshëm të Bindit apo Vidasit.

Kënduesi.- Së bashku me edhin, në të njëjtin monument nga Romula-Malva (monumenti 1) paraqitet edhe kënduesi, i cili gjendet në anën e majtë të Perëndeshës, i vendosur mbi një altar në këndin e poshtëm të monumentit. Kënduesi është një kafshë htonike që paraqitet tek shumë popuj dhe si apotropeion, mbrojtës i njeriut nga demonët e natës dhe rreziqet e tjera.⁴⁰ Në Ballkan është dëshmuar më shumë tek ilirët e veriut, rrjedhimisht në kompleksin kulturor të Alpeve lindore, tek histrët dhe japodët.⁴¹ Kënduesi më së shpeshti është i pranishëm në varëset prej bronzi - amuletet, që mbronin nga fatkeqësitë e ndryshme. Ai është paraqitur edhe mbi urnat që u

³³ A. Stipčević, v.c., 172.

³⁴ D. Rendić, T. LXIX.

³⁵ B. Filov, Die archaische Nekropole von Trebenishte am Ochrid, Berlin und Leipzig, 1927, 53.

³⁶ Lartësia 6,5 cm, gjatësia 6,5 cm, gjerësia 3 cm, pesha 0.380 gr.

³⁷ M. Veličković, Rimska sitna bronzana plastika u Narodnom Muzeju, Beograd, 1972 fig.106.

³⁸ Vazhdimësinë e kësaj tradite autoktone ilire e gjejmë të ruajtur në traditën shqiptare, si në Kanunin e Lekë Dukagjinit, ku cjapi apo cjapi mbarsës-ugiçi konsiderohet si shtazë e parë e çmuar që s'guxon të preket, para dashit e qenit nën vargoj, ashtu edhe në stemën e Skënderbeut, ku gjendet koka e cjapit dhe brirët, si dhe në përkrenaren e Skënderbeut me brirë cjapi.

³⁹ M. Green, Symbol and Image in Celtic Religious Art, Routledge, London and New York, 1989, 9-10.

⁴⁰ Sipas besimit të popujve të ndryshëm, këndimi në orët e hershme të mëngjesit i dëbon demonët e natës, andaj edhe vendoset në kulme të shtëpive.

⁴¹ A. Stipčević, v.c., 66, 68-69: Kënduesi i paraqitur me xhufkë e qerre mban në vete simbolizmin e rrugëtimit diellor.

zbuluan në trojet juglindore të Alpeve, tek latobijët parahistorik. P. Petru e sheh këtë paraqitje tek ilirët si ndikim kelt, por A. Stipçeviq provon autoktoninë e kultit dhe simbolin e kënduesit si mbrojtje nga fatkeqësitë, syri i keq, demonët e këqinj dhe në funksion të qetësisë së të vdekurve, duke theksuar se ky simbol është përhapur në trojet ilire në parahistori, para ardhjes së keltëve.⁴²

Figura më e hershme e kënduesit në trojet dardane është figura realiste nga Fafosi pranë Mitrovicës.⁴³ Kjo dëshmon se kulti i kënduesit nuk i ka rrënjët në Mesopotami, siç është menduar, dhe se në Greqi ariti tek në shek. VII-VI p.e.r. Faktikisht, figura e kënduesit nga Fafosi neolitik dhe paraqitja e tij pranë shtatores së Perëndeshës provojnë një traditë të hershme të kultit të gjelit në trojet dardane. Këto paraqitje dëshmojnë, po ashtu, për një shtrirje më të gjerë të kultit të kënduesit tek ilirët, dhe jo vetëm tek ilirët e veriut, siç ishin latobijët, histrët e japodët. Duhet përmendur se kënduesi paraqitet edhe në reverset e monedhave të shekujve V-IV të qytetit Dardanus në Trojadë,⁴⁴ gjë që shtron çështjen e përhapjes së këtij kulti, si dhe përcaktimin e lidhmërive midis dardanëve evropianë dhe të atyre të Trojadës. Praninë e kënduesit pranë Perëndeshës Dardane, si edhe në rastet e tjera, duhet parë në funksionin e tij apotropëik, por në këtë rast mbase duhet pasur parasysh edhe simbolizmin e rrugëtimit diellor, të cilin e mban në vete kënduesi me xhufkë dhe qerre.

Derri faran.- Derri faran del si atribut përcjellës në shtatoren e Perëndeshës Dardane nga Mediana (monumenti 4). Derri faran ishte simbol përcjellës edhe i hyjneshës Diana.

Shporta e bollëkut.- Në monumentin e fragmentuar nga Romula-Marva (monumenti 2), në pjesën e poshtme të anës së majtë, gjendet shporta e bollëkut e mbushur me fruta. Shporta e bollëkut është një simbol kulti më rrënjë të hershme parahistorike. Brirët e shtazëve duken që në artin paleolitik si simbole plleshmërie të vendosura në duart e Venerave paleolitike, siç është rasti me Venerën nga shpella Laussel në Francën Jugore.⁴⁵ Më vonë briri mbushet me fruta, duke u transformuar kështu në bririn parahistorik të bollëkut, si një burim i pashtershëm i mirëqenies dhe që lidhet me kultin e

⁴² I njëjti, v.c., 171.

⁴³ T. Vukanović, Neolithic Terra-Cotta Cock from Kosovo, Vranjski Glasnik, Vranje, 1971, fig.1.

⁴⁴ Sylloge nummorum Graecorum, The Royal collection of coins and medals, Danish National Museum 20, Copenhagen, 1945, T.7.

⁴⁵ J. Waechter, Man before History, Oxford-Lausanne, 1976, 128. Ka interpretime se briri në duart e kësaj Venere simbolizon hënën.

Nënës së Madhe. Sipas mitologjisë greke, nimfa Amaltea, si personifikim antropomorf i dhisë, mbushi bririn e thyer me lule dhe fruta dhe ia dha Zeusit dhe ky, në shenjë mirënjohjeje që dhia e kishte ushqyer si foshnjë, e vendosi bririn dhe dhinë në radhën e yjeve.⁴⁶ Shporta e mbushur me fruta (*cornuacopiae*) paraqitet më vonë, në vend të bririt. Te keltët shporta e bollëkut bëhet një prej attributeve edhe të hyjneshës Nehalennia, pos qenit si përcjellës i përhershëm, si dhe i Eponës.⁴⁷

Shporta e bollëkut tek monumenti i Romula-Malvës duket të jetë një simbol më i avansuar dhe më i vonë. E vendosur pranë Perëndeshës dhe me funksion magjiko-religjioz shporta me fruta simbolizon bollëkun e natyrës, plleshmërinë dhe mirëqenien e përgjithshme.

Dielli - universi.- Përderisa në monumentet e tjera të Perëndeshës Dardane gjenden paraqitjet figurative të shtazëve, në monumentin nga Smira duket një kompozicion shumë më i avansuar i diellit-universit. Dielli lidhet me kultin solar, i cili ishte më i rrallë në epokën e neolitit, ndërsa elementet e këtij kulti, me paraqitjet e shematizuara të diskut diellor, nisën të dominojnë me fillimin e kohës së metaleve dhe më tej, duke u manifestuar veçanërisht në kulturën e Vuçedollit.⁴⁸ Në epokën e bronzit në Evropë dominonte heliolatria, rrjedhimisht u krijua miti mbi qerren diellore dhe hyjin diellor, të personifikuar në terrakota, si figura të veçanta apo të vendosura në qerre, që i drejtonin shpezët, si simbole të kultit solar.⁴⁹ Refleksion më i vonshëm i këtij kulti duket në plastikën e imtë të epokës së hekurit, në paraqitjet e diskut diellor, të rrotave, si pjesë të qerres diellore - lëvizja diellore, apo të shpezëve, si simbole të diellit.

Kulti i diellit në periudhat e sipërpërmendura është i pranishëm edhe tek dardanët, i dëshmuar nga një varg gjetjesh.⁵⁰ Ai është dëshmuar në objektet e epokës së hekurit dhe në arkitekturën dhe trajtat e vetë tumave, ndërsa

⁴⁶ Ylli Dhia me tre kecat e saj: T. Dhama, v.c., 29, 56.

⁴⁷ M. Green, v.c., 10-11, fig. 2-5; 16, fig. 6.

⁴⁸ N. Tasić - S. Dimitrijević - B. Jović, Praistorija Jugoslavenskih Zemalja, Sarajevo, 1979, 458; A. Stipčević, v.c., 158.

⁴⁹ Ekzemplari më i njohur është Qerrja e Duplajës: B. Cović, Praistorija Jugoslavenskih Zemalja, Sarajevo, 1983, 820.

⁵⁰ E. Shukriu, Kulti i Diellit të dardanët, Studimi etnografik i ndryshimeve bashkëkohore në kulturën popullore shqiptare, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1989, 103-112. Gjurmët e kultit të Diellit janë ruajtur në viset shqiptare, posaçërisht në ato malore. Kështu, në fshatrat e Gollakut (p.sh. në Marec) njerëzit dalin natën maje kodre dhe ndezin zjarre, duke pritur agimin. Shqiptarët e Anamalit në Mal të Zi bartin gurë (kryesisht të rinjtë) deri në maje të malit dhe i vendosin aty, me mëtim të rritet maja e malit, të jetë sa më afër diellit. Këto përcillen me rituale/lojëra të hedhjes së gurëve etj.

kontinuiteti i këtij kulti është i pranishëm edhe tek peonet fqinj në shek.II.⁵¹ Me kultin solar lidhen pjesët e skeptrit, të zbuluar në tumën II në Llashticë të epokës së hekurit.⁵² Pllaka rrethore prej bronzi, me dukje të ngjashme si kompozicioni autokton qendror i monumentit të Perëndeshës nga Smira, janë gjetur në Vrajë e Maqedoni dhe këto mund të indikojnë kultin postdiellor.⁵³ Disku solar gjendet edhe në monedhat peone dhe në ato të Damastionit, të kombinuara me kryqin gremç (svastika).⁵⁴ Simbole të diellit, por jo të ngjashme me të, janë edhe sëpatat, në veçanti ato dytëhëshe /labrys/, që duket se simbolizojnë ndritshmërinë diellore. Labrysi është i pranishëm në varrin e shek. VII p.e.r. në Romajë, ndërsa më vonë duket si atribut përcjellës i Perëndeshës nga Mediana, i vendosur mbi kokën e dërrit faran. Prania e tij shpreh lidhmërinë e fuqishme të Perëndeshës me kultin e diellit.

Në monumentin e Perëndeshës nga Smira simbolet e diellit nuk janë të thjeshta (monumenti 3), siç ndeshen gjetiu, me një apo disa rrathë (në arat me përkushtim Jupiterit dhe, më rrallë, Cererës),⁵⁵ me svastika apo shpezë. Simboli i diellit nga Smira, duke formuar një kompozicion të llojshëm dhe si shprehje e kultit parahistorik solar, në shoqërim me simbolet e tjera, dëshmon kompleksitetin e funksioneve të Perëndeshës dhe të shkallës më të lartë të zhvillimit të religjionit dardan. Simboli qendror në arën e Smirës tejkalon suazat e prezantimit të një kulti parahistorik të diellit dhe ky, duke pasur kuptim më të gjerë, zë sferat e paraqitjes së vetë universit.

Svastika.- Svastika apo kryqi i thyer del nga kombinimi i harqeve në labirintin rrethor të monumentit të Perëndeshës nga Smira (monumenti 3). Svastika, simbol i hershëm parahistorik, në këtë monument nuk është vetëm simbol i rrugëtimit të diellit, por rrembat e saj të kthyer në të djathtë dhe në të majtë simbolizojnë qarkun e përhershëm të qenshmërisë: lindjen, vdekjen, ringjalljen, mbikëqyrjen e së cilës e ka Perëndesha Dardane.

Hardhia e rrushit.- Në monumentin nga Smira, mbi kompozicionin e diellit-universit, gjendet hardhia e rrushit (monumenti 3). Hardhia e rrushit konsiderohej në lashtësi si një pasuri më e çmueshme e njeriut dhe e dalë si

⁵¹ A. Stipčević, Kultni simboli kod ilira, Centar za Balkanološka ispitivanja, knj.10, Sarajevo, 1981, 17, 33, f.n.2.

⁵² Dy shpezë duket se janë vendosur në një objekt të zgjatur me protome shpezësh: N. Vasić, Praistorija Jugoslavenskih Zemalja, Gvozdeno doba V, Sarajevo, 1981, 684.

⁵³ I njëjti, 684, T.LXX, 10.

⁵⁴ J.M.F. May, The coinage of Damastion and the lesser Coinages of the Illyro-Paeonian Region.???

⁵⁵ I njëjti, fig.501, 502, 527.

simbol i pronës paraqet sigurimin e jetës dhe atë që jetën e bën të vlefshme.⁵⁶ Hardhia e rrushit në religjionet e Palestinës së vjetër u konsiderua si bimë e shenjtë, ndërsa prodhimi i saj, vera, si pije hyjnore. Kështu, gjethi i hardhisë u bë simbol i jetës, ndërsa kalaveshi i rrushit (vera/gjaku) ujë i jetës dhe i përjetshmërisë. Hardhia u bë simbol i Dionisit, kulti i të cilit kishte për qëllim të njohurit e jetës sekrete pas vdekjes.⁵⁷ Lidhmëria e Dionisit me misticizmin e vdekjes, që është edhe misticizëm i rilindjes dhe i të njohurit sublim, bën që hardhia të duket shpesh edhe si simbol në monumentet mbivarrore.⁵⁸ Si e tillë, ajo është dëshmuar si simbol karakteristik i monumenteve mbivarrore dardane të periudhës romake. Nga kjo mund të nxirret përfundimi i gabuar se hardhia u soll në Dardani tek pas pushtimeve romake. Nëse kihet parasysh tradita e drugdhendjes tek dardanët dhe kontaktet e tyre të hershme me botën e zhvilluar të jugut, praninë e hardhisë, si prodhim dhe si simbol kulti, tek dardanët duhet parë disa qindra vite më parë. Këtë hershmëri e provon edhe prania e hardhisë në monumentin e Perëndeshës nga Smira, lidhur ngusht me kultin e saj, kult ky që u trajtësua me zhvillimin e shtetit dardan (shek. IV-I). Hardhia në këtë monument e nxjerr këtë nga sfera e ngushtë e kultit të të vdekurve dhe kultin e Perëndeshës Dardane e vë në lidhje me misticizmin e rilindjes dhe të të njohurit sublim.

Lerthi.- Në të njëjtën faqe të monumentit të Smirës gjenden edhe gjethet e lerthit (monumenti 3). Lerthi, bimë përherë e gjelbëruar, u bë simbol i përhapur që simbolizonte përhershmërinë e fuqisë bimore dhe, më vonë, qarkun e përhershëm të vdekjes dhe të lindjes, rrjedhimisht mitin e kthimit të përhershëm. Tek popujt e Lindjes së Afërt lerthi i përkushtohej Atisit në të cilin u dashurua Kibela, hyjnesha agrare e tokës dhe e korjes.⁵⁹ Lerthi së bashku me hardhinë ishin atribut përcjellës i Dionisit. Sipas mitologjisë greke, Dionisi shërbehej me lerthin dhe hardhinë e rrushit që t'i sjellë në gjendje mistike gratë që nuk e përqafojnë kultin e tij. Edhe terrakotat nga Tanagra janë stolitur me gjethet lerthi dhe bathëza, për të cilat mendohej se siguronin mbrojtjen e perëndisë.⁶⁰

Lerthi, si edhe hardhia e rrushit, është simboli karakteristik që paraqitet edhe në monumentet mbivarrore dardane të periudhës romake. Veçmas apo të dyja bashkë u bënë simbole karakteristike të monumenteve sepulkrale të

⁵⁶ J. Chevalier - A. Gheerbrant, v.c., 354.

⁵⁷ Hardhia është prodhim më i vonë se gruri. Gruri, sipas mitologjisë helene, i takon Demetrës.

⁵⁸ J. Chevalier - A. Gheerbrant, v.c., 354.

⁵⁹ I njëjti, v.c., 65.

⁶⁰ I njëjti, v.c., 65.

Dardanisë gjatë periudhës romake, gjithsesi të trashëguara nga antika dardane, nëse jo nga periudha parahistorike. Lerthi duket si ornament edhe në enët dardane të punuara në qark të shek. V-IV.⁶¹ Prania në monumentin e Perëndeshës nga Smira edhe këtë simbol e nxjerr nga rrethi i ngushtë i kultit të të vdekurve dhe e vë në funksion të rilindjes dhe të të njohurit sublim.

Qesja.- Qesja duket si simbol në shtatoren e Perëndeshës Dardane nga Mediana (fot. 7). Ky është një simbol i mëvonshëm dhe i përhapur gjatë periudhës romake, i cili simbolizon pasurinë, përkatësisht bollëkun. Edhe në rastin e shtatores nga Mediana qesja e zëvendëson shportën e bollëkut, që është atribut Perëndeshës nga relievi i gjetur në Rumani.

Nyja.- Nyja gjendet në pjesën e poshtme të kompozicionit të universit në monumentin e Smirës dhe ajo është sajuar nga dy degët e lerthit që lidhen me kompozicionin e labirintit (monumenti 3). Ky simbol, që ka kuptim apotropeik, është mjaft i shpeshtë dhe në vete bart traditat totemike dhe kultet bujqësore të epokës së neolitit. Më vonë nyja u konsiderua si vetë nyjë e jetës apo një labirint përmes të cilit duhet kaluar për të arritur deri tek qendra (zgjdhja dhe çlirimi).⁶² Nyja në arën e Smirës, që i jep kompozicionit kuptimin apotropeik dhe fuqinë profilaktike, po ashtu është një hyrje imagjinate në misteret e jetës.

Labrysi.- Labrysi paraqitet në shtatoren e Perëndeshës nga Mediana dhe është vendosur mbi kokën e derrit faran, pranë këmbës së majtë të hyjneshës (fot. 5). Labrysi apo sëpata dytëhëshe simbolizon diellin apo paraqitet si atribut së bashku me të dhe është shprehje e karakterit dualistik të diellit - ndritshmërisë dhe errësirës. Labrysi duket si instrument sakral në kulte dhe shpesh është shprehje e pushtetit suprem në fazën e hyjnive antropomorfe. Paraqitet në epokën e bronzit dhe në Kretën minoike ishte simbol i ndritshmërisë.⁶³ Sëpata të shumta të epokës së vonë të bronzit në Evropë mbajnë motive diellore, përfshirë edhe svastikën. Është dëshmuar së që në shek. X p.e.r. modelet e sëpatave prej bronzit janë ofruar tempujve të Zeusit në Dodonë e Olimpi.⁶⁴ Sëpata simbolizonte Zeusin rrufehedhës,⁶⁵ zotuesin e shtrëngatave apo zotin suprem, dhe ishte atribut i tij, ashtu siç ishin tek Baali

⁶¹ E. Shukriu, Dardania paraurbane, Dukagjini, Pejë, 1996, 92.

⁶² J. Chevalier - A. Gheerbrant, v.c., 99-100.

⁶³ J. Ferguson, Among the Gods: An Archaeological Exploration of Ancient Greek Religion, Routledge, 1989, 6

⁶⁴ I njëjti, v.c., 26.

⁶⁵ Who's who in the ancient world, Penguin books, Suffolk, 1975, Fot. 31 nr. 8.

oriental Doliheni dhe Zeusi-Hadad, që ishin hyj të shtrëngatës/stuhisë.⁶⁶ Sëpata duket edhe në duart e të ashtuquaturve disk-njeri /*disc-man*/, figura meshkujsh tek të cilët pjesët vitale të trupit kanë trajtë të diskut diellor.⁶⁷

Labrysi shpreh zgjidhjen pozitive të dualitetit, rrjedhimisht dy tehet e sëpatës paraqesin idenë e materializuar të skjashmërive, të cilat i gërsheton çdo dualizëm. Sëpata dyteheshe apo labrysi si atribut i Perëndeshës nga Mediana, si dhe prania e labrysit në varret e epokës së hekurit në tumën e Romajës, e vë këtë simbol në lidhmëri më të hershme me dardanët sesa nga koha e pushtimeve romake. Andaj, edhe dukjen e labirintit në arën e Perëndeshës nga Smira duhet parë në lidhmëri me paraqitjen e labrysit që në epokën dardane të hekurit, si dhe si përkthim i kuptimit simbolik të labirintit rrethor vendës, me një kuptim më të thellë religjioz të të njohurit sublim, fuqisë dhe përjetshmërisë, si e sheh labrysin studiuesi E. Mircea.⁶⁸

Labirinti.- Në faqet e kundërta të monumentit të Perëndeshës nga Smira janë paraqitur dy labirinte: njeri në trajtë rrethi dhe unik dhe tjetri në trajtë katërkëndëshi, i paidentifikuar në pjesën qendrore të Evropës Juglindore (monumenti 3). Paraqitja e labirintit është e shpeshtë në Knosos të Kretës,⁶⁹ Egjipt, Samos dhe në Itali,⁷⁰ si dhe në urnat e hershme etruce në trajtë të shtëpive.⁷¹ Vendosej në portat e qyteteve të fortifikuara helene dhe në maketat e shtëpive të vjetra helene, ndërsa sipas Virgjilit, labirinti ishte i skalitur edhe në dyert e Shpellës së Sibilës në Kumë.⁷² Sipas besimit të hershëm, në qendër të labirintit arrijnë vetëm më të urtit, të cilët i përballojnë sprovat e iniciacionit (korridorët e labirintit), ku ata ndeshin ndriçimin e të njohurit sublim, fuqinë dhe përjetshmërinë.⁷³

Duke mbajtur parasysh se labirinti - pallati i sëpatës dyteheshe, rrjedhimisht sëpata dyteheshe (labrys), simbolizon diellin, simbolet e paraqitura në faqet anësore të monumentit të Perëndeshës Dardane nga Smira përputhen në simbolizmin e tyre. Kështu, këto ofrojnë paraqitjen autoktone të labirintit rrethor, në njerën anë, dhe paraqitjen jo vëndëse të labirintit katërkëndësh, në anën tjetër. Ky gërshetim i labirinteve, me dukje të ndryshme por me kuptim të njëjtë, mund të lidhet me prejardhjen helene

⁶⁶ M. Green, v.c., 53.

⁶⁷ E njëjta, 80-81, fig. 62.

⁶⁸ E. Mircea, v.c., 312.

⁶⁹ B. Kanlif, *Rimsko carstvo, Narodi i civilizacije*, Beograd, 1964, 273.

⁷⁰ Enciklopedija likovne umjetnosti 3, Zagreb, 1964, 273.

⁷¹ B. Kanlif, v.c., 11.

⁷² J. Chevalier - A. Gheerbrant, v.c., 655.

⁷³ E. Mircea, *Traite d'histoire des religions*, Paris, 1964, 312.

të dedikantit, ushtar-vëzhgues i Legjionit IV të Flavëve, i cili shërbeu në Dardani.

Kjo paraqitje është unike si për nga kompozicioni i veçantë ashtu dhe për nga kombinimi me hardhinë, lerthin dhe nyjën profilaktike. Rrathët koncentrikë, ndërlidhja e të cilëve krijon gjashtë svastika dhe tri hapësira të mëdha dhe të ndara, pos diellit dhe rrugëtimit të tij, paralajmërojnë klerarkinë e krijuar të religjionit dardan dhe shkallët e qenshmërisë universale. Sfera në qendër të kompozicionit, e ndarë në tri pjesë, paraqet relacionet midis botës tokësore - qiellore - të nëndheshme, përkatësisht tërësinë qiell-tokë. Simbolet e tjera, që duken në të njëjtën faqe të arës, si hardhia dhe lerthi, e përforcojnë këtë relacion.

III. Kompleksiteti i funksioneve të Perëndeshës Dardane

Analiza e simboleve dhe e ikonografisë së monumenteve përkushtuar Perëndeshës Dardane ofron mundësi për studimin dhe njohjen e funksioneve dhe të rolit të hyjneshës dardane në shoqërinë dardane dhe më gjerë. Shumësia e funksioneve që iu atribuon kësaj hyjneshe në perioda të caktuara kohore dëshmohej nga numri i madh i simboleve që duken në monumentet e saja, siç janë edhe kënduesi, viçi, derri faran, shporta e bollëkut, qesja, hardhia e rrushit, lerthi, nyja profilaktike, labrysi dhe labirinti. Në të njëjtën kohë provohet edhe pozita e lartë që mbante Perëndesha Dardane në panteonin dardan. Hyjnesha të fuqishme, me shumësi të simboleve dhe me shume sfera të ndikimit, janë dëshmuar edhe tek shumë popuj. Trajtimi dhe veshja e tyre vë në pah aspektin e tyre maternal dhe jo atë gjinor. Të tilla janë edhe hyjneshat kelte Nehalennia, me rolin e saj të mbrojtëses, prosperitetit dhe regjenerimit, apo hyjnesha tjetër Epona.⁷⁴

Në dy monumente Perëndesha Dardane është paraqitur duke mbajtur shtazë në kraharor: edhe (monumenti 1), viçi (monumenti 4). Mbajtja në kraharor e shtazëve, të rëndësishme për ekzistencën e njeriut në parahistori, shpreh besimin e shoqërive bujqësore-blegtorale në forcat që ndihmojnë regjenerimin biologjik të natyrës. Kjo, njëkohësisht, ndërlidhet me besimin e hershëm neolitik në Nënë e Madhe (Magna Mater). Kulti i Nënës së Madhe është dëshmuar në Kosovë që në epokën e neolitit, siç provojnë figurat prej balte të pjekur (terrakotat), të zbuluara në Vlashnjë të Prizrenit,⁷⁵

⁷⁴ Miranda Green, *Symbol and Image in Celtic Religious Art*, Routledge, London and New York, 1989, 10-16.

⁷⁵ Hulumtimet e E. Shukriut dhe A. Bungurit të vitit 2002.

Glladnicë pranë Graçanicës⁷⁶ dhe Varosh të Ferizajt, si dhe figurat eneolitike nga Tjerrtorja, Fafosi dhe Bardhoshi.⁷⁷ E parë në këtë dritë, Perëndesha duket trashëgimtare e kultit autokton të Nënës së Madhe, me funksion të plleshmërisë së tokës dhe, më pas, të plleshmërisë universale. Funksioni i saj i plleshmërisë fuqizohet me mbajtjen e edhit dhe të viçit në kraharor, ndërsa shporta e bollëkut, si simbol më i avancuar i bollëkut të natyrës, gjithsesi se e sforcon këtë kuptim të plleshmërisë. Gjurmë të ngjashme të këtij kulti gjenden edhe tek hyjneshat ilire Histria Terra apo Terra Histria, Latra, Iutossica, Sentona, Ica, Anzotica dhe Eia, hyjneshë histriane-liburne, e cila identifikohet me Bona Dea, e cila sipas religjionit të lashtë italik ishte patrone e femrës dhe e plleshmërisë së fushave dhe të kafshëve.⁷⁸ Edhe Epona kelte ka lidhje të ngushta me Nënë e Madhe, të shprehura përmes attributeve të plleshmërisë së tokës (gruri, frutat dhe buka).⁷⁹

Perëndesha Dradane paraqitet edhe si hyj i burimeve, ujërave termale dhe pyjeve. Edhi në kraharorin e Perëndeshës Dardane (monumenti 1), në kontekst me zhvillimet e mëtejme të epokës së metaleve, përkon me cjapin, i cili i është flijuar hyjve ilirë Bindit e Vidasit dhe, siç duket, edhe hyjneshës dardane. Kështu, tek kjo hyjneshë duhet parë edhe funksionet e një hyji të burimeve dhe ujërave, siç i kishte hyji ilir Bindi apo Neptuni romak. Këtë e provon gjetja e monumentit të saj pranë burimit termal të Bajës së Kurshumlisë (monumenti 5). Një rol të ngjashëm kishte edhe hyjneshja kelte Epona, e cila, ngjashëm me hyjneshën dardane, kishte një kompleks funksionesh që i bënë këto të dyja të jenë një formë e *Nënë e perëndive*.⁸⁰ Prania e edhit/cjapit ia shton funksionin edhe hyjit të pyjeve dhe të kullosave, siç e kishin Vidasi dhe Thanë ilire apo Pani helen dhe Fauni / Silvani romak.

Perëndesha Dardane kishte edhe funksionin e hyjneshës së territorit - Dea patriae.⁸¹ Kështu, ndonëse edhe në periudhën romake Perëndesha mbante funksionet e një hyji agraro-blegtoral, nuk ishte vetëm një hyj agrar si Kibela orientale (hyjneshë e tokës dhe e korrjes), apo Demetra me kallinj dhe Dionisi me hardhi. Perëndesha Dardane, po ashtu, nuk ishte vetëm hyj i gjuetisë, si Artemida helene apo Diana romake. Pos këtyre funksioneve, Perëndesha ishte edhe mbrojtëse e territorit, ngjashëm me hyjneshën histriane-liburne Eian, që duket në monumente si Histria Terra, Terra Histria

⁷⁶ M. Garašanin, Centralno balkanska zona, Praistorija Jugoslavenskih zemalja - Neolit, Beograd 1979,

⁷⁷ Hulumtimet e K. Luci të vitit 2002.

⁷⁸ A. Stipčević v.c., 170.

⁷⁹ M. Grenn, v.c., 17, 21.

⁸⁰ M. Green, v.c., 17.

⁸¹ Shih: D. Tudor - C. Vladescu, v.c., 188.

apo vetëm si Histria,⁸² apo me hyjtë e tjerë të territorit: Dii / Deac Daciarum,⁸³ Dea Brigantia⁸⁴ apo Dea Syria.⁸⁵

Paraqitjet e lerthit dhe, në veçanti, paraqitja e hardhisë së rrushit si prodhim më i vonshëm, në monumentin e Perëndeshës nga Smira dëshmojnë lidhjen e këtyre simboleve jo vetëm me kultin e të vdekurve, siç mund të përfundohej në bazë të paraqitjes së tyre deri para ca kohësh në monumentet mbivarrore të Dardanisë. Këto tash vihen në lidhje edhe me kultin e Perëndeshës dhe në funksion të ringjalljes dhe të përjetshmërisë, siç është konstatuar që herçt lidhja e hardhisë së rrushit me kultin e Dionisit. Perëndesha ka rol funeral dhe lidhet me simbolizmin e vdekjes, përmes regjenerimit dhe rilindjes, ngjashëm me Eponën kelte, e cila ka në disa raste atribut çelësash, si simbol të nismës dhe të fundit të jetës.⁸⁶

Prania e kënduesit pranë Perëndeshës Dardane (monumenti 2) ka funksion apotropeik, përkatësisht të mbrojtjes së përgjithëshme nga të këqijat, ndërsa në kuadër të funksioneve të saja duhet parë edhe aspekti sotero-ijatrik, i pohuar më parë.⁸⁷

Labirinti rrethor nga Smira provon praninë e fuqishme të kultit të hershëm të diellit, ndërsa kompozicioni i ndërlikuar dëshmon për ndërlidhjet e krijuara në besimin dardan midis kultit të plleshmërisë, kultit htonik dhe atij solar. Është shumë me rëndësi të ceket se në monumentin e Perëndeshës nga Smira vie në shprehje në mënyrë të veçantë teologjia solare⁸⁸ dhe nuk paraqitet më simboli i thjeshtë i kultit të diellit (rrethi apo rrathët koncentrikë). Rrathët koncentrikë, ndërlidhja e të cilëve krijon 6 svastika dhe tri hapësira, pos simbolit të diellit dhe rrugëtimit diellor, paralajmërojnë klerarkinë e krijuar të religjionit dardan po aq sa edhe shkallët e qenshmërisë. Simbolet e tjera, që duken në të njëjtën faqe të arës, siç janë hardhia dhe lerthi, e përforcojnë këtë relacion.

Duhet cekur se ndarja në tri pjesë e çdo elementi të paraqitur dhe e gjithë kompozicionit është element thelbësor dhe nismë për ta kuptuar botëkuptimin dardan ndaj jetës dhe vdekjes. Këtë ndarje në tri pjesë e dëshmojnë: 1) Paraqitja e gjithë kompozicionit në tri pjesë: hardhia (lart), dielli-universi (në mes), lerthi (poshtë), 2) Ndarja në tri hapësira të veçanta

⁸² A. Degrassi, *Culti dell' Histria preromana et romana*, Zagreb, 1970, 161-167.

⁸³ *Corpus Inscriptionem Latinarum - CIL*, III, 966.

⁸⁴ *CIL VII*, 200, 8075, *CIL XII*, 4883 etj.

⁸⁵ *CIL III*, 7864.

⁸⁶ M. Green, v.c., 18.

⁸⁷ Shih: A. Jovanović, v.c., 62.

⁸⁸ Perandori Aurelian, me prejardhje ilire, u përpoq t'i japë karakter zyrtar universal teologjisë solare, duke ngritur tempullin e Diellit të Pamposhtur: B.Gabričević, v.c., 70.

me gjashtë svastika të pjesës qendrore të kompozicionit, dhe 3) Ndarja në tri pjesë e gjysmësferës së vogël në qendër të kompozicionit. Kjo ndarje tripjesëshe shpreh besimin dardan në ndarjen tokë – nëndhe – qiell. Kjo njëkohësisht shpreh edhe idenë dardane mbi relacionet midis trupit dhe shpirtit, përkatësisht trupit, shpirtit dhe njohurisë/idesë. Në këtë aspekt mund të shërbejnë analogjitë me dëshmitë që gjenden tek Plutarku, i cili shkruan se druidët keltë besonin se njeriu përbëhej nga tri pjesë: trupi, shpirti dhe njohuria (soma, psyche, nous) dhe se trupi lind nga dheu, shpirti nga Hëna dhe njohja-ideja nga Dielli.⁸⁹ Praninë e hardhisë së rrushit⁹⁰ duhet parë si mjet "dionisian" që shpirti ta arrijë ekstazën dhe bashkimin e mundshëm me Diellin / Hyjneshën (njohjen, idenë).

Analiza e monumenteve votive përkushtuar Perëndeshës Dardane shpie në përfundim se është fjala për një hyj autokton, i cili në vete përmban gjurmë të besimit parahistorik dhe të antikës dardane dhe që del i zhvilluar në një hyj sinkretik pak para dhe gjatë periudhës romake. Për rëndësinë e Perëndeshës në shoqërinë dardane dhe më gjerë dëshmon ngritja e monumenteve nga dy dekurionë dardanë në Romula-Malva të largët të Rumanisë dhe e dhëna se monumentin nga Smira e ngriti ushtari romak me prejardhje greke.

Pa dyshim, Perëndesha Dardane është shprehje e zhvillimit të religjionit antropomorf dhe politesitik dardan dhe e zhvillimit paraurban dhe atij urban, që nisi me krijimin e shtetit dardan. Gjatë ecejakeve kohore ajo barti funksionet që i kishin Kibela, Demetra dhe Diana, andaj nuk ishte e rastësishme që fillimisht monumentet e Perëndeshës u panë si dedikime këtyre hyjneshave, për t'u parë më vonë, gjithnjë në relacion me to, si një hyj autokton. Kjo vlen posaçërisht kur është fjala për shtatoren nga Mediana.

Për dallim nga fazat e mëhershme, ku secili hyj kishte funksion të caktuar, sublimimi i funksioneve në një hyj provon një fazë të re të zhvillimit të religjionit dardan. Kjo shprehet në labirintin dhe kompozicionin autokton në monumentin e Perëndeshës nga Smira, ku lerthi si trup/tokë dhe hardhia e rrushit si mjet i arritjes së ekstazës dhe afrisë ndaj hyjnisë, bëhen pjesë përbërëse të labirintit rrethor, përkatësisht të universit. Në këtë mënyrë është inicuar përjetësia universale dhe fuqia që e mban këtë.

Përqendrimi i funksioneve të shumta tek Perëndesha Dardane flet për rrugëtimin e religjionit politeistik dardan, të nisur me krijimin e shtetit dardan në shek. IV p.e.r. dhe mbase të ngadalësuar me pushtimet romake të shek. I. Përqendrimi i funksioneve në një hyj dëshmon edhe për bazat që u krijuan për përhapjen e një religjioni të mëvonshëm monoteistik.

⁸⁹ B. Gabričević, v.c., 71.

⁹⁰ Tek monumentet kelte gjendet simboli i hënës.

IV. Zhvillimi i besimit dhe i religjionit dardan mbështetur në monumentet e Perëndeshës Dardane

Analiza etributeve veç e veç dhe e kompozicioneve nga monumentet përkushtuar Perëndeshës Dardane mundësoi njohjen e funksioneve të kësaj hyjneshe në kohë të ndryshme po aq sa mundësoi edhe krijimin e një pasqyre të përgjithshme të rrugëtimit të besimit dhe të religjionit dardan. Kështu, mund të thuhet se besimi në trojet dardane kaloi nëpër shkallët e ngjashme të zhvillimit si edhe tek shumë popuj të tjerë. Ky kishte karakteristika të përgjithëshme të parahistorisë dhe të antikës, rrjedhimisht nga kulti i shtazëve dhe ai solar u transformua në një besim antropomorf dhe politeistik. Animizmi dhe, më pas, totemizmi dalin faza të zhvillimit të besimit dardan në parahistori (1), antropomorfizmi hyjnor apo politeizmi është fazë që u zhvillua në antikën dardane nga shek. IV p.e.r. (2), ndërsa monoteizmi përqafohet më gjerë nga shekulli IV (3).

Elementet e animizmit, që nënkupton besimin në forcat e mbinatyrshme dhe veprimet e magjisë për mëshirimin e këtyre forcave, përfaqësohen në simbolet përcjellëse të Perëndeshës, siç është edhe apo derri faran, që duket të kenë qenë shtazë që u janë flijuar këtyre forcave. Gjurmët e fazës totemistike, të hyjve në trajtë shtazësh apo të trupave qiellorë, i gjejmë në simbolet e shtazëve, të cilat në antikë bëhentribute të Perëndeshës (edhi, viçi) dhe të trupave qiellorë (dielli). Është me interes të ceket se simboli i gjarpërit nuk paraqitet në mesin etributeve të Perëndeshës Dardane, gjë që këtë e lidh kryesisht me kultin parahistorik të diellit dhe me kultin e ilirëve të veriut.

Në fazat protoantike dhe antike të popujve të ndryshëm totemet morën trajta antropomorfe, andaj në këtë dritë duhet parë edhe paraqitjen e Perëndeshës si hyj antropomorf, e cila, me siguri, në fillim kishte funksione të kufizuara. Paraqitjen e saj, të hyjit Andin, si edhe të hyjve të tjerë vendës, emrat e të cilëve janë ruajtur si *interpretatio romana*, mendoj se duhet lidhur me fuqizimin e dardanëve dhe me paraqitjen e shtetit dardan nga shek. IV p.e.r. Kështu, politeizmi, ku secili hyj ka funksion të caktuar apo disa sosh, lidhet me nismën e antikës dardane. Në fund të kësaj faze paraqiten hyj sinkretikë, që përmbledhin funksionet e disa hyjve, siç është rasti me Perëndeshën Dardane.

Analiza e funksioneve të Perëndeshës Dardane sjell në përfundim se kjo ishte sa hyjneshe e plleshmërisë dhe e territorit, aq edhe psikopomp mortal dhe hierofont iniciacistik, duke u zhvilluar më vonë në një hyj me funksione të ringjalljes së përgjithshme dhe përjetshmërisë, siç duket nga monumenti i Smirës, monument ky me përmbajtje të rrallë teogjenike-kozmozologjike-htonike.

Atributet dhe funksionet e shumta të identifikuar të Perëndeshës Dardane, numri i monumenteve që i janë përkushtuar dhe në veçanti prania e labirinteve, si pasqyrë e universit, e vënë këtë hyjneshë në pozitën supreme të panteonit dardan. Kjo shtron edhe çështjen e rolit fundamental të femrës në shoqërinë dardane, përkatësisht të rëndësisë së parimit femëror në këtë shoqëri, për ç'gjë nuk ka burime të shkruara. Duhet thënë se dominimi i parimit femëror, si vazhdimësi e kultit të Nënës së Madhe, nuk është dukuri e panjohur në shoqëritë antike. Dion Kasi dhe Cezari flasin për praninë e poliandrisë në Britani (Dio Cassius, LXXVI 2; Ceasar, De Bello Gallico V, 14), gjë që flet për rolin udhëheqës të gruas në shoqërinë antike britanike. Një dukuri të tillë e ka konstatuar në shoqërinë kelte studiuesja M. Green, e cila konstaton se hyjneshat kelte Nehalennia dhe Epona përfshinin shumë aspekte të jetës: lindjen, zhvillimin, pllëshmërinë, regjenerimin, mbrojtjen nga demonët dhe deri tek fati i njerëzimit pas vdekjes.⁹¹ Një fuqi të tillë siç duket e kishte edhe Perëndesha Dardane.

Pa dyshim, studimet e mëtejme duhen të thellojnë njohuritë mbi Perëndeshën Dardane, jo aq të njohur deri më tash. Ndërkohë, duhet sqaruar se cili ishte emri i Perëndeshës Dardane: kishte emër të veçantë apo quhej *Perëndeshë* ose *Hyjneshë* dhe ushtaraku grek në shërbim romak vetëm e përktheu emrin në latinishte dhe e vendosi në monumentin nga Smira: *Dea*. Po ashtu, duhet gjetur përgjigje për vendin e hyjve të tjerë në panteonin dardan, për vendin e hyjit Andin dhe të relacionit të tij me Perëndeshën Dardane apo për emrat e hyjve dardanë/ilirë që duken si *interpretatio romana* gjatë periudhës romake.

Funksionet e shumta të sublimuara të Perëndeshës dhe paraqitja e labirintit -Universit në monumentin e Smirës jep të kuptohet se besimi politeistik dardan, i ruajtur deri në shek. III, krijoi baza dhe hapi shtigje për fazën e re të monoteizmit gjithpërfshirës. Kështu, politeizmi, të cilit i paraprin henoteizmi, gradualisht kaloi në monoteizëm. Që nga nisma e krishterizmit në trojet dardane politeizmi dhe monoteizmi bashkëjetuan për një kohë. Mbase këtu duhet parë edhe fuqizimin e Perëndeshës Dardane, si mbrojtëse e traditës dhe si refleksion i saj, përballë sfidave të reja të pushtetit suprem, tokësor dhe qiellor.

Në bazë të monumentit nga Smira mund të përfundohet se kjo fazë paraqet fazën paraprake të kalimit të gjithë energjisë së përhershme në sferën qiellore, gjë që krijoi baza për lindjen e një hyji suprem, monoteistik, të gjithfuqishëm dhe të padukshëm. Në këtë kuptim Krishti, Diell i Ri i

⁹¹ M. Green, v.c., 9.

Drejtësisë (*Sol Institiae*), u shkri me hyjin e hershëm të Diellit,⁹² në këtë rast me Perëndeshën Dardane. Një shkallë e këtillë e zhvillimit të religjionit tek daradanet e bëri të mundshëm sa përfaqimin e hershëm të krishterimit aq edhe krijimin e qendrave të fuqishme të krishterimit në Dardani.

Prof. Dr. Edi SHUKRIU

DEA DARDANICAE – ICONOGRAPHY, SYMBOLS, AND FUNCTIONS

Summary

Dea Dardanicae is a deity with many functions, as seen by a multiplicity of symbols, which reach their climax with the appearance of labyrinth, as a theogenic, cosmologic, and philosophical expression of time. Dea was witnessed in two monuments of Romula-Malva in Romania, and that of Smira, Kosova. The monument of Banja of Kurshumlja and a Palo Christian church in Lypjan were also dedicated to Dea, while it is also presented on the Mediana statue and coin with inscriptions DARDANICI and a bust from Kilokot.

Dea's many functions are also proven by its numerous symbols: he-goat, rooster, calf, and boar, basket of wealth, purse, grapevine, leek, prophylactic knot, labryse, and labyrinth. These prove that Dea was a goddess of fertility and soil and also a mortal psycho pomp and initiate hiero-front, or deity of overall revival and eternity respectively. Dea's attributes and functions, number of monuments and especially the presence of labyrinths represent Dea in a supreme position of the Dardanian pantheon. Through her attributes also the stages of Dardanian belief development are also expressed: animism and, after it, totemic, as prehistoric stages, and polytheism of Dardanian antiquity (4th cen. BC) and monotheism (from the 4th century).

Empowering of Dea Dardanica during the Roman time is seen as a challenge for protecting tradition, and its reflection in face of new challenges of supreme, terrestrial and heavenly power. The sublime functions of Dea and appearance of labyrinth – image of universe in the Smira monument lead to a conclusion that this stage of polytheistic belief lead to the creation of the basis for embracing monotheism, or birth of a supreme monotheistic deity respectively: Christ, New Sun of Justice (*Sol Institiae*).

⁹² Për zhvillime të ngjashme shih: B. Gabričević, *Studije i članci o religijama i kultovima antičkog svijeta*, Književni krug, Split, 1987, 103.